

Këshilla të përshtatshme për alarmet e zjarrit në shtëpi



Një alarm zjarri është një formë jo e shtrenjtë e sigurimit të jetës, meqenëse reagon ndaj tymit të rrezikshëm, duke na dhënë në këtë mënyrë një paralajmërim.

Sa alarme zjarri ju nevojiten?

- Duhet të keni një alarm zjarri në secilin kat të shtëpisë suaj.
- Çdo alarm zjarri duhet të ketë një zonë maksimale të sinjalizimit prej 60 m² dhe largësia midis dy alarmeve të zjarrit nuk duhet të jetë më tepër se 12 metra.
- Alarmet e zjarrit duhet të vendosen pranë dhomave të gjumit. Mbani mend që dyert e mbyllura dhe nivelet e zhurmave të forta, mund ta bëjnë të pamundur që ta dëgjoni alarmin e zjarrit në çdo dhomë gjumi.
- Kontrolloni paketimin për t'u siguruar që alarmi i zjarrit i përmbush kërkesat e standardit SS-EN 14604. Kur jeni në gjumë jeni më në rrezik ndaj tymit dhe zjarrit!

Ku duhet të instalohen alarmet e zjarrit?

Udhëzimet e furnizuesit do t'ju japin

informata se ku duhet të vendosen alarmet e zjarrit, por në përgjithësi zbatohen pikat që vijojnë:

- Alarmet e zjarrit duhet të vendosen në pikën më të lartë të dhomës dhe mundësisht në mes.
- Nëse shtëpia juaj ka më tepër se një kat, alarmi i zjarrit duhet të vendoset aty ku shkallët të çojnë për në katin tjetër.
- Alarmet e zjarrit duhet të vendosen në tavan, jo në mur.
- Alarmet e zjarrit duhet të vendosen të paktën 50 cm larg objekteve të tjera.
- Alarmet e zjarrit nuk duhet të vendosen në vendet e hapura të ventilimit.
- Alarmet e zjarrit nuk duhet të vendosen pranë sobave të gatimit, banjove, garazheve, ose pranë dhomave të zbatitjeve, ku mund të bëjnë që të bien sinjalet e rreme, irrituese të alarmit ndaj zjarrit.

Mos harroni t'i testoni alarmet e zjarrit pasi t'i keni instaluar!

Mirëmbajtja

- Pastrojeni aparatit e alarmit ndaj zjarrit me fshesë elektrike një herë në vit.
- Ne ju këshillojmë bateri litiumi, meqenëse ato kanë jetëgjatësi pesë herë më të madhe se bateritë normale alkaline dhe nuk kanë nevojë të zëvendësohen çdo vit. Nëse do të vendosni të përdorni bateri normale alkaline, atëherë mbani mend t'i zëvendësoni ato çdo vit (për shembull, në fillim të dhjetorit).
- Testojini alarmet e zjarrit çdo tre muaj, ose kur të jeni larguar nga shtëpia për një periudhë të gjatë.
- Zëvendësojini alarmet e zjarrit pas 8-10 vitesh, sepse ato kanë një jetëgjatësi të kufizuar.

Testimi i alarmit të zjarrit

Alarmi i zjarrit mund të testohet duke shtypur butonin e testimit ose duke mbajtur një qiri poshtë alarmit që sapo është shuar.

Ku duhet t'i hidhni alarmet e zjarrit?

Alarmet e zjarrit i përkasin kategorisë së produkteve që duhen hedhur bashkë me mbetjet e tjera elektronike në një qendër riciklimi. Hiqini bateritë dhe vendosini më vete. Alarmin e zjarrit mund t'ia ktheni gjithashtu furnizuesit, kur të blini një të ri.

Mbroni shtëpinë tuaj nga zjarri

Përveç alarmeve të zjarrit, ne ju këshillojmë gjithashtu, që të mbroni shtëpinë tuaj nga zjarri, duke e çuar deri në fund me Brandsäkert hem®. Gjithsej kërkohen vetëm gjashtë hapa:

- Një sistem të sigurt të zbulimit të zjarrit.
- Fikëse zjarri me pluhur 6 kg, kategoria 43A 233BC

- Batanije për shuarjen e zjarrit, me përmasa 120 x 180 cm
- Kontrollues automatik për sobën e gatimit.
- Një dosje që përmban informata për banorët.
- Kursi i trajnimit. Mund të lexoni më tepër për hapat e ndryshme në këtë faqe interneti www.brandsakerthem.se.

TELEFONONI GJITHMONË 112 NË RASTE ZJARRI

Shoqata Suedeze për Mbrojtjen nga Zjarri është një organizatë anëtare, e cila punon për ta bërë Suedinë një vend më të sigurtë. Me anë të informatave dhe trajnimeve, ne i ndihmojmë njerëzit, kompanitë dhe organizatat që të jenë përgjegjëse për parandalimin e zjarrit. 08-588 474 00. www.brandskyddsforeningen.se